



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINË \*MUNICIPALITY ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINE PRISHTINA

Në bazë të nenit 13.7, 14.7, lidhur me nenin 16.2 dhe 19.2 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 03.07.2003, të shpallur sipas Rregullores nr. 2003/30, të dt. 10. 09.2003, nenit 3, par.1, pika "b", të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11. gusht 2000, nenit 19, par.1, pika "b", dhe 40, par.3, pika II. të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.06.2005 merr

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E PROPOZIMPLANIT RREGULLATIV PËR LAGJEN**  
**"QENDRA I" NË PRISHTINË**

Neni 1

Miratohet Propozimplani rregullativ për lagjen "Qendra I" në Prishtinë.  
Propozimplani, nga al. 1 e këtij neni, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe ajo grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërse të këtij Vendimi.

Neni 2

Propozimplani, nga neni 1 i këtij Vendimi, duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit publik.  
Shqyrtimi publik i Propozimplanit rregullativ, sipas këtij Vendimi, zgjat 30 ditë, duke llogaritur nga dita e parë vijuese, pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.  
Organizimin e shqyrtimit publik të Propozimplanit, sipas këtij Vendimi, do ta bëjë Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Neni 3

Pas përfundimit të shqyrtimit publik të Propozimplanit, nga neni 1 i këtij Vendimi, Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë, do t'i kryejë veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij Plani, në mënyrë që, i njëjti t'i prezantohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 4

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01. Nr. 35-14447 dt. 21.06.2005**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**